



Prishtinë: 30.09.2020
Kodi i ZRRE-së: V_1294_2020

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6, neni 14, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L—185);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Dëshmitë e paraqitura nga palët; dhe
- Rekomandimin e ZRRE-së: **ZRRE/DMK_R_2090_09_20**.

në seancën e mbajtur më datë 30.09.2020 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** ankesa e konsumatorit V.F. nga Prishtina si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.
- II. **OBLIGOHET** KESCO që konsumatorit me shifër DPR - 2001868 t'i ofrojë kontratë për pagesë me këste për periudhën dhjetë (10) mujore.

A r s y e t i m

Pranë Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) është parashtruar ankesa nga parashtruesi G.D. me shifër **DPR – 2001868** me të cilën është kundërshtuar përgjigja e lëshuar nga KESCO lidhur me kontestimin e korigjimit plotësues nr.92163DPR-2001868-2001868.

Bordi i ZRRE-së, me qëllimit të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike e cila është iniciuar nga palët në kontest lidhur me pikën matëse të theksuar më lartë ka shqyrtuar dhe analizuar në detaje të gjitha dëshmitë e mbledhura për veprimet e ndërmarra nga palët në kontest lidhur me këtë pikë matëse.

Me datë 03.08.2016 punëtorët e autorizuar të KEDS-it kanë bërë kontrollimin e grupit matës nr.35720905 dhe kanë evidentuar edhe gjendjen e shpenzimit të njehsorit elektrik aktiv nr.35720905 prej TL=10415.315 kWh, gdhe TU=04403.954 kWh, është evidentuar edhe gjendja energjisë reaktive, si dhe gjendja e fuqisë (maksigrafit) është 0,0784 kW. Në procesverbal është theksuar se është bërë kontrollimi i pikës matëse, ku janë kontrolluar urat e tokëzimit që vijnë nga TMRR në njehsor, dhe se TMRR janë 100/5.

Provë: Raporti mbi kontrollimin – pranimin e grupit matës nr.030705 i datës 03.08.2016

Me datë 05.12.2016 punëtorët e autorizuar të KEDS-it kanë bërë kontrollimin e pikës matëse dhe se është theksuar se janë dalur për shkak të mungesës së energjisë dhe se është kontrollimi i pikës matëse duke hjekur bllobat në orman të njehsorit dhe është BA 76014 dhe është hjekur blloba në KPO dhe është BA 76019. Gjithashtu është theksuar se janë vendosur te njehsori bllobat BA 49201 dhe në KPO BA 49216 dhe gjendja është në rregull. Gjendja e shpenzimit e njehsorit elektrik nr.32630256 ka qenë TL=002806 kWh dhe TU=000708 kWh.

Provë: Procesverbali i KEDS nr.2143492 i datës 05.12.2016

Me datë 16.12.2016 punëtorët e autorizuar të KEDS-it kanë bërë kontrollimin e grupit matës dhe kanë bërë ndërrimin e grupit matës, ku kanë larguar nga matja grupin matës nr.32620256 e me gjendje



TL=009236 kWh dhe TU=002320, dhe kanë vendosur grupin matës nr.37437875 me gjendje prej TL=00000 kWh dhe TU=00000 kWh. Gjithashtu duhet theksuar se te pjesa e grupit matës të larguar është evidentuar grupi tarifor 4 (komercial - 7/02), ndërsa te pjesa e grupit matës të montuar është evidentuar grupi tarifor 3 (komercial – 6/6). Në procesverbal gjithashtu është theksuar se ndërrimi i njehsorit bëhet për shkak të pëlqimit shtesë nr.11005 të datës 08.12.2016 si dhe është kërkuar të bëhet edhe ndërrimi i grupit tarifor.

Provë: Raporti mbi kontrollimin – pranimin e grupit matës nr.023442 i datës 16.12.2016

Departamenti i faturimit në KESCO me datë 28.02.2018 e ka ngarkuar konsumatorin me korrigjim plotësues nr.92163DPR-2001868-2001868 në vlerë financiare **2,902.07€**.

Provë: Korrigjimi nr.92163DPR-2001868-2001868 i datës 28.02.2018

Konsumatori me datë 14.03.2018 ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KESCO duke kundërshtuar korrigjimin plotësuese nr.92163DPR-2001868-2001868 të datë 28.02.2018, duke theksuar se kundërshtojnë korrigjimin shtesë prej 2900€ nga viti 2016 dhe se nga ajo periudhë e deri tash nuk është ngarkuar por ngarkohet tani. Konsumatori ka theksuar se shpenzimet e vitit 2016 dhe 2017 i kanë mbyllur dhe se si kompani “Meridian” po dëmtohen.

Provë: Ankesa e konsumatorit

Me datë 16.04.2018 Departamenti për Konsumator në KESCO i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar ankesën e tij duke theksuar se bazuar në procesverbalet konstatohet se gjatë ndërrimit të njehsorit vlera e konstantës ka ngelë ajo e vjetra C=1 në vend të asaj C=40 dhe atë deri në muajin 09/2017 ndërsa konsumi ka rrjedh në rregull dhe se kemi faturim të gabuar të vlerës së maksigrafit prej ditës së zëvendësimi të pikës matëse dhe kalimit nga grupi 7/02 në grupin 6/6 në muajin 12/2016. Nga të dhënat e faturimit në CRMS janë nxjerr të dhënat e faturimit të maksigrafit prej muajit 12/2016 muaj për mua dhe deri më 09/2019, ndërsa muajt 10/2017 dhe 11/2017 ka pasur faturim të rregullt dhe nuk ka nevojë për korrigjimi shtesë.

Provë: Përgjigja e KESCO-s e datës 28.03.2019

Me datë 17.04.2019 konsumatori ka parashtruar ankesë në DMK të ZRRE-së duke kundërshtuar përgjigjën e lëshuar nga KESCO duke kundërshtuar korrigjimin plotësues nr. nr.92163DPR-2001868-2001868 i datë 28.02.2018. Konsumatori në ankesë ka theksuar se korrigjimi shtesë i KESCO është i pabazuar dhe në kundërshtim me gjendjen faktike dhe se faturimi dhe kontrollimi i njehsorëve është në përgjegjësi të KESCK dhe se njehsorët janë të bllobuar dhe nuk ka mundësi që të intervenohet nga jashtë. Poashtu konsumatori ka theksuar se korrigjimin është dashur ta rregulloj me kohë.

Provë: Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së datë 17.04.2019

Bordi i ZRRE-së, duke i analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga konsumatori dhe KESCO, ka vërejtur se:

Në Raportin mbi kontrollimin e grupit matës nr.030705 i datës 03.08.2016 punëtorët e autorizuar të KEDS-it kanë bërë kontrollimin e grupit matës nr.35720905 dhe kanë evidentuar gjendjen e shpenzimit të njehsorit elektrik aktiv nr.35720905 prej TL=10415.315 kWh, gdhe TU=04403.954 kWh, gjendjen energjisë reaktive, si dhe gjendjen e fuqisë (maksigrafit) e cila në periudhë ka qenë 0,0784 kW. Në procesverbal është theksuar se është bërë kontrollimi i pikës matëse, ku janë kontrolluar urat e tokëzimit që vijnë nga TMRR në njehsor, dhe se TMRR janë 100/5.

Provë: Raporti mbi kontrollimin – pranimin e grupit matës nr.030705 i datës 03.08.2016

Duhet theksuar se konsumatori me shifër DPR – 2001868 Agron Gashi “Meridian Express”) kanë bërë kërkesë për rritje të fuqisë e cila deri në atë periudhë ka qenë 50kW dhe se ka kërkuar që të rritet edhe për 60 kW, e që në total i bie se fuqia maksimale e njëkohshme është 110 kW. Për këtë KEDS ka lëshuar Pëlqimin Elektroenergjetik nr.11005 të datës 08.12.2016 ku përveç kushteve teknike të parapara është theksuar se matja e energjisë elektrike do të bëhet me njehsor multifunksional (aktive, reaktive dhe



maskigraf) 5A dhe me TMRR 200/5. Pra nga kjo shihet qartë se me rritjen e kërkesës është bërë edhe ndryshimi i grupit matës, e njëkohësisht edhe të TMRR, pra tani konstanta llogaritëse duhet të jetë $C=40$.

Në Raportin mbi kontrollimin e grupit matës nr.023442 të datës 16.12.2016 punëtorët e autorizuar të KEDS-it kanë bërë dhe kanë bërë ndërrimin e grupit matës, ku kanë larguar nga matja grupin matës nr.32620256 e me gjendje TL=009236 kWh dhe TU=002320, dhe kanë vendosur grupin matës nr.37437875 me gjendje prej TL=00000 kWh dhe TU=00000 kWh. Gjithashtu duhet theksuar se te pjesa e grupit matës të larguar është evidentuar grupi tarifor 4 (komercial - 7/02), ndërsa te pjesa e grupit matës të montuar është evidentuar grupi tarifor 3 (komercial – 6/6). Në procesverbal gjithashtu është theksuar se ndërrimi i njehsorit bëhet për shkak të pëlqimit shtesë nr.11005 të datës 08.12.2016 si dhe është kërkuar të bëhet edhe ndërrimi i grupit tarifor.

Provë: Raporti mbi kontrollimin – pranimin e grupit matës nr.023442 i datës 16.12.2016

Gjatë analizës së bërë të dy raporteve të grupeve matëse nr.030705 të datës 03.08.2016 dhe nr.023442 i datës 16.12.2016 vërehet se në raportin e parë të grupit matës nr.030705 të datës 03.08.2016 TMRR kanë me qenë me konstanta $C=20$ (100/5), ndërsa në raportin e dytë të grupit matës nr.023442 i datës 16.12.2016 TMRR kanë me qenë me konstanta $C=40$ (200/5). Bazuar në këtë të gjithë llogaritjet e energjive aktive, reaktive dhe maksigrafit do të duhej të faturoheshin me konstantën $C=40$.

Bazuar në analizën e bërë rrjedhës së energjisë elektrike aktive dhe transaksioneve të konsumatorit vërehet se konsumatori ka lexim të rregullt të pikës matëse. Sipas analizës së bërë rrjedhës së energjisë elektrike aktive dhe transaksioneve të konsumatorit vërehet se konsumatori fillimisht ka pasur në funksion grupin matëse nr.35720905 i cili ka pasur edhe konstantë llogaritëse $C=20$ dhe ka qenë duke u faturoar në grupin tarifor 4 (7/02 ose 0.4 kV kategoria II) deri më 10/2016, pastaj nga periudha 10/2016 deri më 12/2016 ka qenë në funksion grupi matës nr.32630256 i nuk ka pasur konstantë llogaritëse dhe është faturoar në grupin tarifor 4 (7/02 ose 0.4 kV kategoria II), pastaj nga periudha nga periudha 12/2016 e tutje konsumatori ka në funksion grupin matës 37437875 i cili ka konstantën llogaritëse $C=40$ (bazuar në PEE nr.11005 të datës 08.12.2016) dhe se nga periudha 12/2016 ka filluar të faturohet në grupin tarifor 3 (7/02 ose 0.4 kV kategoria I, konsumatorët e mëdhenj me energji reaktive). Nga analiza e bërë rrjedhës së energjisë elektrike dhe transaksioneve të konsumatorit vërehet se konsumatori nga periudha 12/2016 e tutje kur grupi matës nr.37437875 është vendosur energjia aktive është llogaritur me konstante llogaritëse $C=40$, por që fuqia nga periudha 12/2016 e deri më 10/2017 nuk është llogaritur me konstantë llogaritëse $C=40$, po është llogaritur me konstantë $C=1$, e që kjo ka qenë një gabim i vet KEDS/KESCO, pasi ata janë përgjegjës për leximin dhe faturimin e pikës matëse. Duhet theksuar se ky është gabim i vet KEDS dhe KESCO pasi sipas Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, OSSH është përgjegjës për leximin e pikave matëse, ndërsa Furnizuesi për faturimin e saj

Në nenin 28, paragrafi 1 i Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji theksohet se: *“Furnizuesi është i detyruar të sigurojë që konsumatorët të jenë të faturoar për energjinë e shpenzuar e dhe për tarifën tjera, sipas strukturës tarifore të përcaktuar dhe në përputhje me llojin e tarifës të dakorduar me Konsumatorin (nëse është e aplikueshme)”*, por që duhet theksuar se në rastin e konsumatorit në fjalë Furnizuesi nuk ia ka faturoar tërë energjinë e shpenzuar gjatë periudhës 12/2016 deri më 10/2017, pra nuk ia ka faturoar pjesën e fuqisë maksimale (maksigrafin). Në nenin 28, paragrafi 3 i Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, theksohet se: *“Në rast të gabimeve që rrjedhin prej të dhënave të leximit të pasaktë të njehsorit, të cilat shkaktojnë faturim të pasaktë, Furnizuesi do të bëjë të gjitha korrigjimet (rregullimet) e nevojshme në faturën vijuese”*, e që në rastin e konsumatorit në fjalë KESCO me datë 28.02.2018 ka bërë korrigjimin shtesë duke ia ngarkuar konsumatorit vetëm pjesën e fuqisë maksimale (maksigrafin) me konstantën llogaritëse $C=40$.



Bordi i ZRRE ka analizuar korrigjimin shtesë nr.92163DPR-2001868-2001868 të datës 28.02.2018 në vlerë prej 2902.07€, bërë nga Departamenti i faturimit në KESCO dhe ka vërejtur se korrigjimi shtesë përfshin periudhën 12/2016 deri më 09/2017 ku është bërë korrigjimi i pjesës së fuqisë (maksigrafit) për këtë periudhë nga ajo e llogaritur me konstantë C=1 me konstantën C=40. Pra Bordi i ZRRE gjatë analizës së bërë korrigjimit shtesë konstaton se korrigjimi shtesë nr.92163DPR-2001868-2001868 i datës 28.02.2018 është i saktë.

Bordi i ZRRE në ZRRE bazuar në të gjitha shkresat, e veçanërisht bazuar në Raportin mbi kontrollimin – pranimin e grupit matës nr.023442 të datës 16.12.2016, rrjedhën e energjisë elektrike aktive dhe transaksionet e konsumatorit konstaton se nga periudha 12/2016 e deri më 10/2017 konsumatorit në fjalë KESCO nuk ia ka faturuar tërë energjinë elektrike të shpenzuar, respektivisht nuk ia ka faturuar pjesën e fuqisë maksimale (maksigrafin) sipas konstantës C=40, andaj ajo pjesë është shpenzuar nga konsumatori dhe si e tillë edhe duhet të faturohet si korrigjim shtesë bazuar në nenin 28, paragrafi 1 dhe 3 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji. Por pasi që në rastin e konsumatorit, gabimi gjatë faturimit ka qenë i KESCO-s, atëherë KESCO duhet t'ia ofroj konsumatorit një marrëveshje pagese me këste për një periudhë dhjetë (10) mujore.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 30.09.2020 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Arsim Janova, u.d. kryesues

Besim Sejfiqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Konsumatorit: V.F. (parashtruesi G.D.)
- KESCO-së dhe
- Arkivit të ZRRE-së.